



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion  
Mbledhja nr. 09/2010

Prishtinë më 02. 03. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Qamile Morina, Nerxhivane Dauti dhe Zef Morina.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi dhe Mufëra Şinik.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dukagjin Shala dhe Imet Shala – MEM, Besim Zeqiri – ICO, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Visar Ramaj – KDI, Lelja Selimi – OSBE, Lumnije Murati - ZPRK, dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

**Stafi mbështetës:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ethem Çeku – zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**R e n d i d i t ë s :**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të 23. 02. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale,
4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërimin e Bordit të Hekurudhave të Kosovës,
5. Të ndryshme.

**Kryetarja** - Njoftoi se për shkaqe shëndetësore nuk mund ta kryesonte mbledhjen dhe kërkoi nga zëvendëskryetari i parë i Komisionit, Ethem Çeku, ta kryesonte mbledhjen.

**Kryesuesi** - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23. 02. 2010**

*Kryesuesi i Komisionit konstatoi se procesverbali i mbledhjes së 23 .02. 2010 miratohet pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale**

**Kryesuesi** – Theksoi se kryesuesja e Grupit të punës për Projektligjin nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, Sala Berisha – Shala, e paraqet vazhdimin e Draftdokumentit për shqyrtim dhe hapi debat.

**Sala Berisha – Shala** – Si kryesuese e Grupit të punës për Projektligjin për miniera dhe minerale e paraqiti Draftdokumentin e Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale. Para se të vazhdonte ku kishte mbetur nga mbledhja e kaluar i paraqiti edhe disa ndryshime që ishin bërë edhe në pjesën e parë të shqyrtuar, si në vijim: neni 2, paragrafi 2, plotësohet, neni 18, paragrafi 3, plotësohet, neni 21 dhe neni 31, shtohet neni i ri 1.12.

Vazhdoi me paraqitjen e ndryshimeve dhe të vërejtjeve nga pjesa VII, përkatësisht neni 43, deri në fund të Projektligjit.

**Kryesuesi** – Theksoi se ka ende çështje të hapura dhe kur të vijë Raporti me amendamente do të shqyrtohet dhe do të miratohet.

*Pas debatit Komisioni nxori këtë*

#### ***Përfundim***

- *Në mbledhjen e radhës të procedohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.*
- *Procesverbalit i bashkëngjitet Draftdokumenti i propozuar nga grupi i punës nga neni 43 deri në nenin 88 të Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.*

### **4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Hekurudhave të Kosovës**

**Kryesuesi** – Njoftoi se ka arritur nga Qeveria Propozimvendimi për emërimin anëtarëve

të Bordit të Hekurudhave të Kosovës. Po ashtu tha se janë propozuar të njëjtit anëtarë që Komisioni me Rekomandim i ka kthyer prapa dhe hapi debat për këtë çështje. Shtoi se ka ardhur në adresë të Komisionit edhe një shkresë nga sekretari i MTPT-së, në të cilën kërkohet më ngulm të miratohet ky Propozimvendim. Kryesuesi e quajti këtë komunikim joserioz dhe jo në nivel.

**Zef Morina** – Theksoi se pavarësisht ngjyrimin politik që po i jepet kësaj çështjeje, duhet ta kalojmë situatën e krijuar, sepse mund të mbetemi pa borde nëse i paragjykojmë të propozuarit për anëtarë të bordeve. Theksoi se nuk është e mundur të mos ketë ekspertë të kësaj fushe. Në fund tha se duhet të kalojë ky Propozimvendim, sepse më mirë është ta kemi një bord, sesa të mos e kemi fare. Është çështje e tij pastaj si do të punojë.

**Kryetarja** – Theksoi se nëse Kuvendi është vendi ku miratohen ligjet dhe Komisioni rekomandon se një propozim i tillë duhet të kthehet prapa, sepse përbën shkelje të ligjit, shtrohet pyetja: Ku mbetet ndërgjegjja e këtij Komisioni? Tha se po të merret parasysh se vendi ka mjaft ekspertë të kësaj fushe, nuk do të duhej që Qeveria të propozonte kandidatë të papërvojë dhe joprofesionistë.

**Qamile Morina** – Theksoi se është joserioze nga ana e Qeverisë, që e ka krijuar këtë situatë, kur në agjencitë e pavarura nuk ka borde. Është bërë praktikë të bëhen lëshime dhe shmangie të tilla, duke e shkelur ligjin, kur dihet se çfarë aseti i rëndësishëm janë hekurudhat. Shtoi se kjo gjendje është krijuar nga papërgjegjshmëria e Qeverisë. Komisioni nuk duhet ta lejojë një gjë të tillë. Propozoi të kthehet prapa ky Propozimvendim, sepse Qeveria po e përsërit gabimin e njëjtë, duke insistuar ta plotësojë Bordin me kandidatë të njëjtë, edhe pse Komisioni ka rekomanduar se ata nuk i plotësojnë kushtet.

**Sala Berisha – Shala** – Theksoi se në lidhje me këtë çështje po veprohet me logjikën refuzuese opozitare. Duke apostrofuar te kandidatët shtoi se njëri prej tyre ka qenë deputet dhe anëtar i këtij Komisioni dhe është i diplomuar në gjeologji, kurse një tjetër është ekonomist dhe ka përvojë në menaxhim, prandaj i plotësojnë kushtet për anëtarë të Bordit. Kërkoj që anëtarët e Komisionit t'i shmangen logjikës refuzuese, të jenë opozitë konstruktive dhe ta përkrahin Propozimvendimin e Qeverisë për Bordin e Hekurudhave.

**Ethem Çeku** – E lexoi Rekomandimin e Komisionit e 24. 11. 2009, me të cilin Komisioni nuk e mbështet Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/71 të 03. 07. 2009 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës dhe i ftoi deputetët të votojnë Për ose Kundër Propozimvendimit të Qeverisë nr. 03/3257/No-2050 të datës 18. 02. 2010, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës.

*Komisioni më tri (3) vota Për dhe me tri (3) Kundër e nxori këtë*

### ***Rekomandim***

*I. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e mbështet Propozimvendimin e*

*Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/3257/No-2050 të datës 18. 02. 2010 për emërim të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave në Republikën e Kosovës;*

- II. *Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të propozojë kandidatë të tjerë për anëtarë të Bordit të Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, ngase të kandiduarit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin për Hekurudhat në Republikën e Kosovës.*

## **5. Të ndryshme**

### **a) Projektligji nr. L-097 për masat antidamping dhe kundërbalancuese**

**Kryesuesi** – Për shkak se në këtë Projektligj asistonte USAID-i, gjatë gjithë kohës, kërkoi nga përfaqësuesi i tyre të deklarohej lidhur me këtë çështje.

**Haxhi Gashi (USAID)** – Theksoi se janë hequr vërejtjet që janë dhënë në seancën e leximit të dytë dhe tani janë përfshirë në Raport.

*Pas debatit Komisioni e nxori këtë*

### ***Përfundim***

- I. *Miratohet Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. L-097 për masat antidamping dhe kundërbalancuese.*
- II. *Autorizohet njësia mbështetëse e Komisionit që Raportin ta procedojë për seancë plenare në lexim të tretë.*

### **b) Mbledhja e radhës**

**Kryesuesi** – Njoftoi se mbledhja e radhës do të mbahet më 09. 03. 2010. Për rendin e ditës do të njoftoheni më kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 30

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetarja e Komisionit**

---

**Myzejene Selmani**